LIGJ
Nr.10 063, datë 29.1.2009

PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË PROTOKOLLIN "PËR REDUKTIMIN E SHKARKIMEVE TË SQUFURIT APO TË FLUKSEVE TË TYRE NDËRKUFITARE, TË PAKTËN NË MASËN 30 PËR QIND" TË KONVENTËS SË VITIT 1979 "PËR NDOTJEN NDËRKUFITARE TË AJRIT NË DISTANCË TË LARGËT"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në protokollin "Për reduktimin e shkarkimeve të squfurit apo të flukseve të tyre ndërkufitare, të paktën në masën 30 për qind" të konventës së vitit 1979 "Për ndotjen ndërkufitare të ajrit në distancë të largët".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6045, datë 6.2.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

PROTOKOLLI I KONVENTËS I VITIT 1979
PËR NDOTJEN NDËRKUFITARE TË AJRIT NË DISTANCË TË LARGËT MBI REDUKTIMIN E SHKARKIMEVE TË SQUFURIT OSE TË FLUKSEVE TË TYRE NDËRKUFITARE TË PAKTËN NË MASËN 30%

Palët,

të vendosura për të zbatuar Konventën për ndotjen ndërkufitare të ajrit në distancë të largët;

të shqetësuara nga fakti që shkarkimet aktuale të ndotësve të ajrit, po shkaktojnë dëmtime të mëdha në pjesët e ekspozuara të Europës dhe Amerikës së Veriut, ndaj burimeve natyrore me rëndësi jetike për mjedisin dhe ekonominë, të tilla si pyjet, toka dhe ujërat, si edhe ndaj materialeve të ndryshme (duke përfshirë monumentet historike) dhe që në rrethana të caktuara kanë efekte të dëmshme për shëndetin e njeriut;

të vetëdijshme për faktin se burimet mbizotëruese të ndotjes së ajrit, të cilat kontribuojnë në acidifikimin e mjedisit, janë djegia e lëndëve djegëse fosile për prodhimin e energjisë, proceset kryesore teknologjike në sektorë të ndryshëm të industrisë, si edhe transporti, të cilat çojnë në shkarkimin e dyoksidit të squfurit, oksideve të azotit dhe ndotësve të tjerë;

duke pasur parasysh që duhet t'i jepet një përparësi e madhe reduktimit të shkarkimeve të squfurit, çka do të ketë rezultate pozitive nga pikëpamja mjedisore, për situatën ekonomike në tërësi dhe shëndetin e njeriut;

duke kujtuar vendimin e marrë nga Komisioni Ekonomik për Europën (KEE) i Kombeve të Bashkuara në sesionin e tij të 39-të, i cili theksoi nevojën urgjente të shtimit të përpjekjeve për të arritur në strategji dhe politika kombëtare të bashkërenduara në rajonin e KEE-së me qëllim që të reduktohen në mënyrë të efektshme shkarkimet e squfurit në nivelet kombëtare;

duke kujtuar njohjen nga organi ekzekutiv i Konventës në sesionin e tij të parë të nevojës për të pakësuar efektivisht shkarkimet totale vjetore të përbërjeve të squfurit ose të flukseve të tyre ndërkufitare gjatë periudhës 1993-1995, duke përdorur nivelet e vitit 1980 si bazë për llogaritjet e reduktimeve;

duke kujtuar se Konferenca shumëpalëshe për shkaqet dhe parandalimin e dëmtimeve të pyjeve dhe ujërave nga ndotja e ajrit në Europë (Munih 24-27 qershor 1984) kërkoi që organi ekzekutiv i Konventës të miratojë, si një çështje me përparësi të madhe, propozimin për një marrëveshje të veçantë mbi reduktimin e shkarkimeve kombëtare vjetore të squfurit ose të flukseve të tyre ndërkufitare jo më vonë se viti 1993;

duke vërejtur se një pjesë e palëve kontraktuese të Konventës kanë vendosur të zbatojnë reduktimet e shkarkimeve të tyre kombëtare vjetore të squfurit ose të flukseve të tyre ndërkufitare të paktën deri në masën 30 % sa më shpejt të jetë e mundur, dhe jo më vonë se viti 1993, duke marrë nivelet e vitit 1980 si bazë për llogaritjet e reduktimeve;

duke pranuar, nga ana tjetër, se disa prej palëve kontraktuese të Konventës, pavarësisht se nuk e kanë firmosur këtë protokoll në momentin e hapjes së tij për nënshkrim, megjithatë do të japin një kontribut të rëndësishëm në reduktimin e ndotjes ndërkufitare të ajrit, ose do të vazhdojnë të bëjnë përpjekje për të kontrolluar shkarkimet e squfurit, siç deklarohet në dokumentin që i bashkëngjitet raportit të organit ekzekutiv në sesionin e tij të 3-të,

kanë rënë dakord si më poshtë vijon:

Neni 1

Përkufizime

Për qëllimet e këtij Protokolli:

1. "Konventa" është Konventa për ndotjen ndërkufitare të ajrit në distancë të largët, e miratuar në Gjenevë më 13 nëntor 1979.

2. "EMEP" është programi i bashkëpunimit për monitorimin dhe vlerësimin e zhvendosjes në distancë të largët të ndotësve të ajrit në Europë;

3. "Organi ekzekutiv" është organi ekzekutiv i Konventës i krijuar sipas paragrafit të parë të nenit 10 të Konventës.

4. "Zona gjeografike e veprimit të EMEP" është zona e përcaktuar në paragrafin 4 të nenit 1 të Protokollit të Konventës së vitit 1979 për ndotjen ndërkufitare të ajrit në distancë të largët në lidhje me financimin afatgjatë të programit të bashkëpunimit për monitorimin dhe vlerësimin e zhvendosjes në distancë të largët të ndotësve të ajrit në Evropë (EMEP), i miratuar në Gjenevë më 28 shtator 1984.

5. "Palët" janë, përveç rastit kur konteksti e kërkon ndryshe, palët në këtë protokoll.

Neni 2

Dispozitat themelore

Palët duhet të reduktojnë shkarkimet e tyre kombëtare vjetore të squfurit ose të flukseve të tyre ndërkufitare të paktën në masën 30%, sa më shpejt të jetë e mundur, dhe jo më vonë se viti 1993, duke marrë nivelet e vitit 1980 si bazë për llogaritjen e këtyre reduktimeve.

Neni 3

Reduktimet e mëtejshme

Palët njohin nevojën e secilës prej tyre për të studiuar në shkallë kombëtare domosdoshmërinë për reduktime të mëtejshme, përtej niveleve që iu referohet neni 2, të shkarkimeve të squfurit ose të flukseve të tyre ndërkufitare, në rast se kushtet e mjedisit e kërkojnë një gjë të tillë.

Neni 4
Raportimet mbi shkarkimet vjetore

Çdo palë duhet të informojë çdo vit organin ekzekutiv në lidhje me nivelin e shkarkimeve të tyre vjetore të squfurit dhe bazën mbi të cilën ato janë llogaritur.

Neni 5
Përllogaritjet e flukseve ndërkufitare

EMEP-i duhet që, në kohën e duhur, para mbledhjeve vjetore të organit ekzekutiv, t'i sigurojë organit ekzekutiv përllogaritjet e sasive të squfurit, si edhe të flukseve ndërkufitare dhe depozitimeve të përbërjeve të squfurit për secilin vit të mëparshëm brenda zonës gjeografike të veprimit EMEP-it, duke përdorur modelet e përshtatshme. Në rajonet jashtë zonës gjeografike të veprimit të EMEP-it, duhet të përdoren modele të përshtatshme me rrethanat e veçanta të palëve.

Neni 6
Programet, politikat dhe strategjitë kombëtare

Palët duhet që, në kuadrin e Konventës, të hartojnë pa vonesë, programet, politikat dhe strategjitë kombëtare, të cilat do të shërbejnë si një mënyrë për të reduktuar shkarkimet e squfurit ose flukset e tyre ndërkufitare, të paktën deri në masën 30% sa më shpejt të jetë e mundur, dhe jo më vonë se viti 1993, dhe duhet të raportojnë në lidhje me këtë në organin ekzekutiv, si dhe për ecurinë në drejtim të arritjes së këtij synimi.

Neni 7
Amendamentet e protokollit

1. Çdo palë mund të propozojë amendamente të këtij protokolli.

2. Propozimet e amendamenteve duhet të paraqiten me shkrim në sekretariatin ekzekutiv të Komisionit Ekonomik për Europën, i cili ua komunikon ato të gjitha palëve. Organi ekzekutiv duhet të diskutojë amendamentet e propozuara në mbledhjen e tij vjetore më të afërt, me kusht që propozimet të jenë qarkulluar tek palët nga sekretariati ekzekutiv i Komisionit Ekonomik për Europën të paktën 90 ditë më parë.

3. Një amendament i këtij protokolli duhet të miratohet me konsensusin e përfaqësuesve të palëve, dhe do të hyjë në fuqi për palët që e kanë pranuar atë në ditën e 90-të pas datës në të cilën dy të tretat e palëve kanë depozituar instrumentet e tyre të pranimit të këtij amendamenti. Amendamenti do të hyjë në fuqi për çdo palë tjetër në ditën e 90-të, duke filluar nga data në të cilën kjo palë depoziton instrumentet e saj të pranimit të këtij amendamenti.

Neni 8
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Në rast se lind një mosmarrëveshje midis dy ose më shumë palëve përsa i përket interpretimit ose zbatimit të këtij protokolli, ato duhet të kërkojnë një zgjidhje nëpërmjet bisedimeve apo nëpërmjet çdo mënyre tjetër për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të pranueshme për palët në konflikt.

Neni 9
Nënshkrimi

1. Ky protokoll do të jetë i hapur për nënshkrim në Helsinki (Finlandë) nga data 8 korrik 1985 deri në dhe duke e përfshirë datën 12 korrik 1985, nga vendet anëtare të Komisionit Ekonomik për Europën, si dhe nga vendet e pranuara me statusin konsultativ pranë Komisionit Ekonomik për Europën, në pajtim me paragrafin 8 të Rezolutës 36 (IV) datë 28 mars 1947 të Këshillit Ekonomik dhe Social, si edhe nga organizatat e integrimit ekonomik rajonal, të krijuara nga shtetet sovrane anëtare të Komisionit Ekonomik për Europën, të cilat kanë kompetenca në drejtim të zhvillimit të negociatave, lidhjes dhe zbatimit të marrëveshjeve ndërkombëtare në lidhje me çështjet që trajtohen nga ky protokoll, me kusht që shtetet dhe organizatat e interesuara të jenë palë në Konventë.

2. Përsa u përket çështjeve që janë brenda kompetencave të tyre, këto organizata të integrimit ekonomik rajonal duhet që, në emër të tyre, të ushtrojnë të drejtat dhe të përmbushin detyrat dhe përgjegjësitë që cakton ky protokoll për vendet e tyre anëtare. Në raste të tilla, vendet anëtare të këtyre organizatave nuk mund t'i ushtrojnë këto të drejta individualisht.

Neni 10
Ratifikimi, pranimi, miratimi dhe aderimi

1. Ky protokoll duhet të ratifikohet, pranohet apo miratohet nga vendet nënshkruese.

2. Ky protokoll do të jetë i hapur për aderim nga ana e shteteve dhe organizatave të referuara në paragrafin 1 të nenit 9, duke filluar nga data 13 korrik 1985.

3. Një shtet ose një organizatë që aderon në këtë protokoll pas hyrjes së tij në fuqi, duhet të zbatojë nenin 2 jo më vonë se viti 1993. Megjithatë, në qoftë se aderimi në protokoll ka ndodhur pas vitit 1990, neni 2 mund të zbatohet nga pala në fjalë pas vitit 1993, por jo më vonë se viti 1995 dhe për pasojë kjo palë duhet të zbatojë nenin 6.

4. Instrumentet e ratifikimit, pranimit, miratimit ose të aderimit do të depozitohen pranë Sekretariatit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, i cili ushtron funksionin e personit të besuar.

Neni 11
Hyrja në fuqi

1. Ky protokoll do të hyjë në fuqi ditën e 90-të pas datës së depozitimit të instrumentit të gjashtëmbëdhjetë të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit.

2. Për çdo shtet ose organizatë të përmendur në paragrafin 1 të nenit 9, i cili ratifikon, pranon ose miraton këtë protokoll, ose aderon në të pas depozitimit të aktit të gjashtëmbëdhjetë të ratifikimit, pranimit, miratimit apo aderimit, protokolli do të hyjë në fuqi ditën e 90-të pas datës së depozitimit nga kjo palë e aktit të saj të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit.

Neni 12
Tërheqja

Në çdo moment pas pesë vjetësh, duke filluar nga data në të cilën ky protokoll ka hyrë në fuqi për një palë të caktuar, kjo palë mund të tërhiqet nga ky protokoll duke bërë njoftim me shkrim në drejtim të personit të besuar. Çdo tërheqje e tillë do të hyjë në fuqi ditën e 90-të pas datës së marrjes së njoftimit nga personi i besuar.

Neni 13

Tekstet origjinale

Origjinali i këtij protokolli, tekstet e të cilit në anglisht, frëngjisht dhe rusisht, janë njëlloj autentike, do të depozitohen pranë Sekretariatit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

Në dëshmi të kësaj, nënshkruesit e autorizuar ligjërisht, kanë nënshkruar këtë protokoll.

- Bërë në Helsinki më 8 korrik 1985.